





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Ekstrakt nga procesverbali, mbledhja e njëmbëdhjetë XI-të, e rregullt e Kuvendit të Komunës, e mbajtur më datë 31.10.2019, ora 10:00h, në Sallën e Kuvendit të Komunës.

Prezentë në mbledhje ishin anëtarët e Kuvendit të Komunës: Vjollca Konjusha - Kryesuese e Kuvendit të Komunës, Remzi Shala, Ilir Hasani, Arjeta Jashari, Mirvete Gërguri, Jetmir Berisha, Albert Jasharaj, Miranda Shabani, Sabit Bullatovci, Ali Zogiani, Betim Ahmeti, Durim Hajra, Eglantina Azemi, Doruntina Jashari, Aida Alimi, Arjana Zogiani, Naser Graiçevci, Migjen Kolshi, Mehdi Lahu, Shaban Ademi, Driton Ademi, Ali Ismaili, Driton Hasolli, Hysni Hasani, Bashkim Krasniqi dhe Ljubisa Qirkoviq.

Mungon: Sabri Rexhepi.

Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës: Fadil Krasniqi - Nënkyetar i Komunës, Ramadan Jashanica - Drejtor i Financave dhe Buxhetit, Nuriye Fazliju - Drejtore e Administratës dhe Nuriye Avdiu - Drejtore e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Jakup Tërrnava - Drejtor Gjeodezisë, Kadastër dhe Pronë, Islam Shabani - Drejtor i Arsimit, Maliq Berisha - Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Mjedisit dhe Afrim Krasniqi - Drejtor i Inspektoratit.

Të tjerë: Lindita Dervisholli/Prebreza - Zyrtare e Njësitit për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore dhe përfaqësuesit e OSBE-së.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës përshëndeti të pranishmit në mbledhje, pas verifikimit të prezencës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës, konstatoi se ekziston kuorumi për mbajtjen e mbledhjes dhe prezantoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e datës 26.09.2019.
2. Pyetje dhe përgjigje parlamentare.
3. Propozim për rritjen e të hyrave vetanake për vitin 2019.
4. Propozim për ndërtimin e objektit shkollor në Fushë-Kosovë.
5. Propozim për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.
6. Të ndryshme.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës përshëndeti të pranishmit në mbledhje, konstatoi se ekziston kuorumi për mbajtjen e mbledhjes, më pas lexoi pikat e rendit të ditës të parapara për shqyrtim në mbledhjen e sotme dhe hapi diskutimin.

Driton Ademi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Për shqyrtim sot i kemi tri pika të rendit të ditës të cilat duhet të riformulohen sa i përket aspektit formal dhe definimit më të qartë të tyre, po ashtu, unë propozoi që pjesë e rendit të ditës të jetë edhe 'Propozimi për themelimin e Komitetit për Politikë e Financa', në përputhje me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2018 për përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të Përhershme, kjo pikë paraqet një urgjencë edhe në aspektin kohor të realizimit të dispozitave ligjore dhe akteve

nënligjore, që e definojnë qartë mënyrën e themelimit dhe përbërjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, kjo punë është dashur të kryhet sipas udhëzimit administrative në muajin mars, ku subjektet politike përfaqësohen me nga një asambleistë në komitet sipas rradhitjes së subjekteve politike dhe rezultatit zgjedhor. Te propozimi për rritjen e të hyrave vatanake, ato janë të planifikuara në fillim si të hyra nga taksat dhe tarifat tjera, andaj nuk na takon neve të votojmë propozime fiktive ku caktohen shumat dhe nuk dihen parametrat për caktimin e tyre, te propozimi për ndërtimin e shkollës, materiali i dorëzuar për shqyrtim nuk përputhet me propozimin, këtu kemi të bëjmë me këmbimin e pronës, që lejohet për persona fizik dhe juridik, por kur definohet qartë interesi publik, duke respektuar procedurat dhe hapat që i parasheh ligji.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin për përfshirjen në rendin e ditës të kërkesës së asambleistit z. Driton Ademi për themelimin e Komitetit për Politikë e Financa sipas ligjit dhe udhëzimit administrativ.

U votua me: trembëdhjetë vota 'për', dymbëdhjetë 'kundër', gjithsej njëzetepesë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, e aprovoi për shqyrtim rendin e ditës së propozuar, me 'Propozim për themelimin e Komitetit për Politikë e Financa'.

Pika e parë (1) - Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës, e datës 26.09.2019.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për aprovim, ekstraktin e procesverbalit nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës, e mbajtur më datë 26.09.2019, nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim për diskutimet tuaja.

Ali Ismaili: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë e kam një sugjerim për përmirësimin e diskutimit tim, te ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar, në faqen e tretë të plotësohet fjalia të cilën e lexoi si në vijim: Ndërtimi është duke u bërë nga fqinji im në mënyrë jo të mirë, ne tani jemi njëzet vite pas luftës dhe na duhet të reagojmë në mënyrën më të vështirë për palën, kur nuk reagojnë organet e shtetit, andaj 'përmirësimi i fjalisë në fund duhet të jetë në mënyrën më të 'ashpër', për arsye të realizimit të drejtave tona që na takojnë' dhe në faqen e gjashtë te mjetet e planifikuara nga Drejtoria e Arsimit në buxhet nuk është shuma e mjeteve financiare prej 40.000.00€ për blerjen e kamerave për shkolla, por shuma është 140,000.00€.

Pasi që vërejtje apo sugjerime tjera për përmbajtjen e ekstraktit të procesverbalit nuk pati nga anëtarët e Kuvendit të Komunës, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur më datën 26.09.2019, me përmirësimin e cekur nga anëtari i Kuvendit të Komunës z. Ali Ismaili.

U votua me: gjashtëmbëdhjetë vota 'për', nëntë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e pesë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e aprovoi ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e

mbajtur më datën 26.09.2019, me përmirësimin e cekur nga anëtari i Kuvendit të Komunës z. Ali Ismaili.

Pika e dytë (2) - Pyetje dhe përgjigje parlamentare.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi pikën 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare', ftoi anëtarët e Kuvendit të Komunës që të parashtrojnë pyetjet e tyre për Ekzekutivin e Komunës.

Durim Hajra: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë i kam disa pyetje për Drejtorinë e Komunës. Pyetja ime e parë ka të bëjë, me peticionin që i është dërguar për ta shqyrtuar Drejtorinë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, Drejtorinë së Planifikimit Urban, Drejtorinë së Inspektoratit, Kryetarit të Komunës dhe Kryesueses së Kuvendit të Komunës, nga ju znj. Kryesuese e Kuvendit të Komunës, është kërkuar që këtë peticion ta vendosni për shqyrtim në Kuvendin e Komunës dhe me nga një kopje të tij, t'i njoftoni Shefat e Grupeve Parlamentare të përfaqësuara në Kuvendin e Komunës, ju këtë nuk e keni bërë. Peticioni ka të bëjë me ndërtimet në rrugën 'Zahir Pajaziti' dhe 'Pjetër Budi' në Fushë-Kosovë, jashtë kriterëve dhe kushteve për ndërtimin e objekteve kolektive të banimit. Pyetja e dytë ka të bëjë me kërkesën e banorëve të fshatit Harilaç për Drejtorinë e Arsimit që është në kompetencën e komunës, e jo si është thënë disa herë nga përfaqësuesit e Ekzekutivit të Komunës për ndërtimin e mbikalimit në fshatin Miradi e Poshtme, ku qytetarët kanë shumë vështërsi, madje ka patur edhe viktimë, se kjo është në kompetencën e Ministrisë së Infrastrukturës. Këtu kemi të bëjmë, me një kërkesë që nëntëmbëdhjetë nxënësit e rrugës 'Mehmet Gradica' të cilët kërkojnë që t'iu sigurohet transporti në largësi prej 2.2km, sepse nxënësit nga klasa e parë deri në të pestën janë të rrezikuar edhe nga qentë endacak, kjo punë nuk kushton më shumë se 300.00€ në muaj, ose këtë nxënës do të shkojnë në shkollat e Komunës së Lipjanit, nëse kërkesa e tyre nuk përkrahet dhe nuk gjindet një zgjidhje nga Drejtoria e Arsimit.

Migjen Kolshi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Para dhjetë ditëve, unë i kam bërë dy kërkesë për qasje në dokumente publike, njëra lidhur me tenderin për blerjen e dy kombibusëve dhe një auto-ambulance nga komuna dhe tjetra për Drejtorinë e Inspektoratit, për të dytën nuk kam marrë përgjigje, në këtë rastë është shkelur ligji, i cili e definon që përgjigjësja duhet të kthehet brenda afatit ligjor prej shtatë ditëve. Unë kam hulumtuar lidhur me këtë punë edhe në doganë, minibusi i blerë nga komuna është prodhim i vitit 2009, ndërsa auto-ambulanca prodhim i vitit 2014. Minibusi me njëzet e dy ulëse, prodhim i vitit 2007, 2008 është blerë në shumën prej 32,000.00€, ndërsa në doganë këto automjete kushtojnë maksimum 15,000.00€ deri në 17,000.00€, auto-mabulanca prodhim i vitit 2013 është blerë në shumën prej 116,500.00€, ndërsa kushton 51,000.00€ në treg, meqë këtu kemi të bëjmë me pacientë edhe nuk duhet të kursejmë shumë, për kundër shumës së lartë kësaj auto-ambulance i mungojnë dritat, gjendja në shëndetësi është e rëndë, unë sot këtë dosje të tenderit do t'i dërgoi në Prokurorinë e Shtetit, sepse këtu kemi të bëjmë me hajni dhe keqpërdorim të buxhetit të komunës. Unë nuk di si blihet auto-ambulanca kur në pranimin e saj nuk merr pjesë asnjë doktor. Nga autoriteti kontraktues komuna jonë është caktuar një Kompani për rrënimin e ndërtimeve pa leje në shumën prej 56,604.00€ përmes një kontrate kornizë, vendime për rrënimë kemi, tani e kemi edhe kontratën, pyes Drejtorin e Inspektoratit pse nuk vepron në terren. Edhe nëse nuk rrënohet asnjë object në territorin e komunës, Kompania

fitues i merrë mjetet financiare nga buxheti i komunës. Unë pyes, Drejtorin e Inspektoratit, pse as pas shtatë ditëve nuk kam përgjigje lidhur me kërkesën time, tani jemi në ditën e dhjetë. Pyes, Drejtoreshën e Administratës, pse në raportin e punës për gjashtëmujorin e parë, na ka gënjyer se funksionon sistemi i vajtje/shkuarjes së punëtorëve në punë, kur kjo nuk është e vërtetë, ne nuk jemi të vegjël, jemi përfaqësues të zgjedhur në Kuvendin e Komunës, andaj ajo duhet të na kërkoj falje.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: Ju lutem të mos komentoni e sqaroni, por të shtroni pyetje për Ekzekutivin e Komunës.

Migjen Kolshi: Po ashtu, unë kam një pyetje edhe për konkursin e komunës të shpallur nga Drejtoria e Administratës në kundërshtim me ligjin e ri për zyrtarët public, që ka hyrë në fuqi me njëmbëdhjetë shtator, ligji i vjetër është shfuqizuar, këto konkurse do të anulohen. Ju i keni shkelur procedurat e testimit, sepse Kryetar i Komunës ka qenë nëpunësi Ardit Sekiraga i cili është në kohën e punës provuese, për të qenë Kryetar i Komisionit duhet të ketë së paku tre vjet përvojë pune dhe kualifikimin adekuat sipas ligjit, në këtë rast në marrëdhënie pune është pranuar punëtori Donat Zharku, i cili nuk i plotëson kushtet e konkursit. Unë pyes, në bazë të cilit ligj janë shpallur vendet e lira të punës me datën 12 shtator, këto konkurse sipas ligjit do të anulohen.

Nënkryetari i Komunës: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Konkursin janë aprovuar nga Ministria e Administratës Publike, në bazë të sistematizimit të vendeve të punës, që është planifikuar nga Komuna e Fushë-Kosovës dhe nuk lidhen me fushatë zgjedhore, këtu kemi të bëjmë me nivelin lokal.

Migjen Kolshi: Kërkesa e komunës ka qenë që të punësohen dhjetë inxhinier, e jo nga Drejtoria e Arsimit për shpallet konkurs për ndërtim, që lidhet me Drejtorinë e Planifikimit Urban, andaj lidhur me këtë metodë të punësimit unë kërkoj sqarime nga ju.

Aida Alimi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë kam një kërkesë që ndërlidhet me personat me nevojë të veçanta, ku ne e kemi aprovuar 'Planin e Veprimtimit për persona me nevojë të veçantë', i cili parasheh që të caktohet një zyrtarë i komunës, i cili do të merret me këtë punë dhe të krijojë një data-bazë, me të dhëna për këtë kategori të ndieshme të popullsisë. Ne do ta denim sa persona janë me autizëm, sa me sindromin daën. Unë kam qenë në një kontroll sistemetike shëndetësor për shtatëzani në ambulantën tonë dhe kam pritur më shumë se një orë, mjekun i cili për teket e tij nuk ka qenë në vendin e punës, kjo është e pa pranueshme, andaj kërkoj nga Shefi i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë, që të ndërmerrë masa konkrete për ndryshimin e gjendjes aktuale.

Mehdi Lahu: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë e kam një pyetje për Drejtorinë e Arsimit, salla e sportit në shkollën 'Daut Bogujevci' nuk funksionon, nxënësit detyrohen që ushtrimet nga lënda e Edukatës Fizike t'i zhvillojnë në objektin e ri të 'Shkollës së mesme teknike', me mirëkuptimin e Drejtorit të shkollës, duhet të bëhet një zgjidhje. Në Shkollën ekonomike nuk ka ngrohje, nxënësit po i shfrytëzojnë nxemëset që po i bartin me dorë. Unë e kam edhe një pyetje tjetër për Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, gropimet në rrugë që po hapen nga Kompania e Ujësjetillës Rajonal 'KUR Prishtina', kush është i obliguar t'i sanojë në rrugët tona, në këtë drejtim duhet të ndërmerrni diçka. Nënkalimi në Bresje, ka problem me ndriçimin publik,

andaj ju kisha lutur që në bashkëveprim me organet kompetente Policinë e Kosovës, të shtohen kontrollat në mbrëmje, sepse aty po tubohen të rinjtë dhe ka dyshime, se aty po përdoren edhe substancat narkotike. Sa i përket pastërtisë aty është pastruar nënkalimi disa herë nga komuna, unë mendoj se duhet të vendosen drita në hyrje dhe dalje në logjistikën ekzistuese që është aty në skajet e rrugës dhe shkollës, si dhe të shtohen kontrollat nga policia.

Shaban Ademi: Përsëritës të pranishmit në mbledhje. Unë e kam një pyetje për Zyrën Ligjore, se a paraqet konflikt të interesit puna e asambleistit z. Betim Ahmeti, i cili është i punësuar edhe si Sekretar i shkollës, në shkollën fillore 'Daut Bogujevci' në Fushë-Kosovë dhe njëkohësisht edhe asambleist në Kuvendin e Komunës, i cili në të njëjtën kohë i mban dy pozita të punës. Unë dy herë kam qenë në situatë të tilla, njëherë Drejtor i Shtëpisë së Kulturës dhe një herë Koordinator i Muzeut Komunal dhe jam tërhequr, sepse e kam dashur punën në Kuvendin e Komunës. Pyetja tjetër e imja lidhet me parkingjet, ku e kemi një katrahurë të vërtetë, për këtë dëshmitar e kam Nënkrëtarin e Komunës, unë kërkoi që së paku njëherë në muaj, kur kemi mbledhje të Kuvendit të Komunës, të lirohet për ne parking që i është marrë Qendrës shëndetësore. Po ashtu edhe ambienti në Komunën e Fushë-Kosovës është shumë i ndotur, është bërë pyllëzim nëpër zonat pyjore, por ndotja më e madhe është në qytet, ku një ditë në një television është paraqitur gjendja alarmante e automjeteve në Fushë-Kosovë, këtë pluhur e thithin të gjithë, por më së shumti punëtorët e administratës dhe shëndetësisë që janë për ditë në qytet, duhet të ndërmerren masa konkrete për pastrimin e ambientit, të pastrohen rrugët në qytet. Dua ta shtroi këtu një problem që ndërlidhet me tre nxënës shqiptar të fshatit Radevë, të cilët mësimin e mbajnë në shkollën e fshatit Henc, kërkoi që të rregullohet vigu i vjetër, i cili nuk kushton shumë, ose duhet të sigurohet transporti për këta tre nxënës. Në fshatin Henc është duke u ndërtuar një Palestër Sportive, ku është mbyllur dera e shkollës që shërben për ngrohje, punëtori teknik aty Besimi më tha se nuk mund ta kryen punën e tij, unë e pyeta mbikëqyrësen e projektit znj. Fatmire ajo më tha se dera nuk hapet, sepse nuk është me projekt. Kërkoi që Drejtoria e Arsimit të kujdeset për zgjidhjen e këtij problemi. Në vizitën e fundit në Shqipëri kanë shkuar kush ka dashur nga Administrata e Komunës, shëndetësia, kultura e tjerë, unë mendoj se do të ishte mirë të krijohet një rend, të mos veprohet në mënyrë selektive, edhe ne si Kuvendi i Komunës mund ta marrim një vendim për vizitë në Shqipëri, sepse kur vjen koha për miratimin e buxhetit të komunës, ne jemi ata që e votojmë.

Remzi Shala: Përsëritës të pranishmit në mbledhje. Unë do të jap një sqarim për asambleistin znj. Aida Alimi, meqë u përmenda unë si Shef, që jam aty, për mjekësinë e përgjithshme nuk ka termin, për shërbimet në laborator dhe gjinekologji ka termin, gratë shtatëzëna duhet të kontrollohen me termin. Po ashtu edhe në stomatologji dhe në pediatri nuk ka termin.

Doruntina Jashari: Përsëritës të pranishmit në mbledhje. Unë e kam një pyetje për Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, ku kërkoi që ndriçimi publik të funksionon pa ndërprerje, sepse po ka probleme nëpër rrugë të ndryshme, shpenzimet të plënikohen me kohë.

Drejtori për Arsim: Përsëritës të pranishmit në mbledhje. Lidhur me udhëtimin e nxënësve nga fshati Harilaç i Vogël, kjo punë i takon Komunës së Lipjanit, pasi ata nxënës gravitojnë në territorin e asaj komune, largësia aty është më pak se dy kilometra, me tender këtë punë nuk mund ta rregullojmë, ne jemi të interesuar që në bashkëpunim me Komunën e Lipjanit ta bëjmë një

zgjidhje për këta nxënës vitin e ardhshëm. Të dy shkollat në Fushë-Kosovë kanë salla të sportit, edhe objekti i vjetër edhe objekti i ri shkollor. Në objektin e ri investitor është Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, e cila nuk e ka përfunduar punën e saj, ato punë që janë obligime tona do të zgjidhen në mes të dy Drejtorive të shkollave. Në objektin e shkollës kemi problem edhe me ngrohje, problem me ngrohje është rregulluar sot. Kam biseduar me punëkryesin dhe dera e shkollës do të hapet në fshatin Henc, këtu kemi të bëjmë me një gabim, i cili do të evitohet dhe zgjidhet.

Drejtori për Shërbime Publike dhe Mjedis: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Lidhur me mbikalimin, rregullimi i tij është një nevojë e natyrshme për qytetarët, por ne e kemi bërë një zgjidhje të përkohëshme nën urën e fshatit. Komuna pa lejin dhe ndërhyrjen e Ministrisë së Infrastrukturës, nuk mund ta bënë mbikalimin, jemi munduar, por kemi problem, sepse prona është private. Sa i përket rregullimit të rrugëve ne çdo herë intervenojmë, po ashtu kemi bërë intervenime edhe sa i përket ndriçimit publik, vitin e kaluar kemi patur problem në fund të vitit, për arsye të mbylljes së buxhetit, por ndonjëherë ka edhe raste të prishjes, jo vetëm të pagesave. Te nënkalimi në Fushë-Kosovë, ndriçimin publik e kemi rregulluar dy herë, policia patrollon edhe në qytet edhe në fshatrat Vragoli dhe Miradi e Poshtme, por nevojitet një vetëdijësim më i madh i qytetarëve.

Mirvete Gërguri: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Lidhur me ndriçimin duhet të dihen saktë prishjet dhe problemet teknike, të cilat nuk ndërlidhen me pagesat e rrymës.

Nënkryetari i Komunës: Anëtar i Kuvendit të Komunës z. Migjen Kolshi këtu ngriti akuza të rënda, kjo punë do të analizohet dhe vlerësohet, përgjigjet do të jepen në mbledhjen tjetër, ndërsa sa i përket Kompanisë për rrëime, rastet duhet të shikohen një nga një, cilat duhet të legalizohen dhe cilat nuk i plotësojnë kushtet për legalizim?

Migjen Kolshi: Unë këtu fola publikisht, ata që nuk bëjnë shkelje dhe keqpërdorime i mbron ligji, këtu kemi të bëjmë me hajni dhe dëmtim të buxhetit të komunës.

Shaban Ademi: Unë nuk mora përgjigjeje për pyetjet e mia, as për parkingjet, as për konfliktin e interesit dhe as për rregullimin e vigut?

Nënkryetari i Komunës: Parkingu i komunës për asambleistët njëherë në muaj në ditën kur ka mbledhje të Kuvendit të Komunës, mund të rregullohet, për vigun duhet të shqyrtohet puna nga Drejtoria e Planifikimit Urban. Sa i përket peticionit ai mund të parashtrohet edhe nga dy veta, pa ndonjë arsye, disa të tjerë nganjëherë vetëm e nënshkruajnë, pa e ditur fare se çfarë po bëjnë.

Durim Hajra: Këtu kemi të bëjmë me një çështje serioze, ku Drejtoria e Inspektoratit duhet të marrë veprime konkrete.

Pika e tretë (3) - Propozim për rritjen e të hyrave vetanake për vitin 2019.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim, 'Propozimin për rritjen e të hyrave vetanake për vitin 2019', ftoi Drejtorin e Financave dhe Buxhetit që të na jap sqarime.

Drejtori për Financa dhe Buxhet: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Propozimin për rritjen e të hyrave vetanake për vitin 2019, e kemi diskutuar dhe sqaruar edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, rritja e të hyrave vetanake përtej planifikimit vjetor të buxhetit lejohet, duke u mbështetur në dispozitat e 'Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjit për Menaxhimin e

Financave Publike dhe Përgjegjësi'. Ne e kemi planifikuar rritjen e të hyrave vetanake në disa kategori ekonomike buxhetore, duke filluar nga pagat dhe mëditjet, kuhyn mësimi jo formal, pastaj mallëra e shërbimet për disa shkolla, subvencionet e transferet dhe fund investimet kapitale, të dhënat në shifra konkrete i kemi të shënuara sipas kodeve të programeve, nënprogrameve dhe kodet e projekteve publike dhe investive.

Durim Hajra: Ne disa sqarime i kemi marrë edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa, por ato nuk na bindin, sepse këtu kemi të bëjmë me mospajtime sa i përket planifikimit të buxhetit dhe rishpërndarjes së mjeteve financiare nëpër kode ekonomike. Në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, përfaqësuesi i sindikatës së arsimtarëve ka kërkuar që të bëhet pagesa e pagave jubilarë, ajo nuk është e planifikuar as këtu, këtu kemi planifikim për mësimin jo formal, ne kemi vërejtjet tona edhe për shpërndarjen e shumave edhe në kategorinë e subvencioneve, në x kode ekonomike, p.sh në Zyrën e Kryetarit të Komunës, shuma prej 30,000.00€ është e lartë, këto mjete financiare do të duhet të ndahen për Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, ku nevojat janë më të mëdha. Ndahen mjete financiare për kulturë, por jo sa duhet edhe për zhvillimin e sportit. Në lagjen 'Dardania' dhe në lagjen e 'Xhigolëve' vazhdojnë ndërtimet kolektive, kurse mungojnë hapësirat për fëmijë.

Naser Graiçevci: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë i uroi të gjithë për zgjedhjet e mira, tani do ta kemi edhe Ekzekutivin e përgjegjës në nivel vendi dhe shpresojmë se do t'i kthehet shpresa rinisë dhe qytetarëve. Rritja e buxhetit të komunës sa i përket të hyrave vetanake për 22.5% në tre muajt e fundit të vitit, tregon qartë se planifikimi i buxhetit nuk është bërë në baza reale. Shpërndarja e tij në kategori ekonomike, nuk është bërë si duhet, ne kërkojmë sqarime për mjetet financiare të planifikuara për paga dhe mëditjeve, në disa shkollat tjera janë nga 5,000.00€, ndërsa për shkollën e fshatit Sllatinë e Madhe janë 10,000.00€, në kategorinë ekonomike të subvencioneve nuk pajtohem me 50% të shpërndarjes së tyre, në Zyrën e Kryetarit të Komunës 30,000.00€ nuk pajtohem, në Buxhet e Financa 20,000.00€ nuk pajtohem, në shëndetësi 80,000.00€ pajtohem, unë propozoi që shuma e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të rritet për 20,000.00€ dhe ato të merren nga Buxheti dhe Financat, në mënyrë që të ndihmohen klubet sportive, aty ku grumbullohet rinia jonë dhe aty mund t'i shprehin aftësitë e veta. Në arsim për çfarë do të përdoren mjetet financiare, ne kemi mungesë të informacioneve.

Drejtori për Arsim: Ne kemi shumë kërkesa të pa realizuara të studentëve, të cilëve u kemi ndarë mjete financiare.

Naser Graiçevci: Te kategoria ekonomike e subvencioneve për kulturë, rini dhe sport duhet të kyqen të rinjtë, projektet e tyre duhet të përkrahen, unë këtu po e shoh edhe pozicionin për shtëpitë për rastet sociale, duhet në na sqarohet neve, se a kemi të bëjmë me ndërtime, apo renovime të shtëpive.

Driton Ademi: Grupet Parlamentare dhe subjektet politike të përfaqësuara në Kuvendin e Komunës, diskutuan për qasjen e tyre, planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve duhet të bëhet për periudha të caktuara, planifikimi shtesë duhet të jetë minimal dhe të bëhet në bazë të analizës dhe atë për kategori të caktuara ekonomike, që nuk mund të planifikohen saktë. Kjo ndarje krijon pa barazi nëpër programe të buxhetit komunal.

Drejtori për Financa dhe Buxhet: Planifikimi i të hyrave vetanake për vitin 2019, ka qenë në shumë të mjeteve financiare prej 3,045,000.00€, kjo shumë ne mendojmë se gjatë muajve tetor, nëntor dhe dhjetor do të tejkalohet, andaj duhet ta bëjmë rritjen e të hyrave vetanake për vitin 2019. Shuma mund të rritet nga tatimi në pronë, lejet e ndërtimit. Nga mjetet financiare të planifikuara për subvencione në Zyrën e Kryetarit të Komunës ne i përkrahim Organizatat Jo Qeveritare, në shëndetësi dhe arsim mjetet financiare të planifikuara janë të nevojshme, pajtohem që shuma e mjeteve financiare prej 20,000.00€ nga Buxheti dhe Financat, të bartet për shpenzim në kulturë, rini dhe sport, te kategoria ekonomike e komunalive ndriçimi publik e rritë koston e shpenzimeve prej 50,000.00€.

Remzi Shala: Ne si Grup Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, kur e ftojmë Drejtorin për Financa dhe Buxhet, për sqarimin e shpenzimeve, ai vjen dhe na sqaron për secilin kod ekonomik, besoi se ai i përgjegjet secilit Grup Parlamentar kur ata e ftojnë. Ne e përgëzojmë Ekzekutivin e Komunës për punën e bërë dhe tejkalimin e buxhetit orientimisht për shumën e propozuar, që hyn në funksion të plotësimit të nevojave të qytetarëve në arsim, shëndetësi, kulturë dhe sport, andaj në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrahim për aprovim 'Propozimin për rritjen e të hyrave vetanake për vitin 2019'.

Driton Ademi: Ai kur ftohet nga ne duhet të vjen, por jo të identifikohet me grupin e juaj parlamentarë.

Ali Ismaili: Parafolësit e mi po thuaj se i thanë të gjitha, por unë në dy vitet e fundit kam vënë në pah disa gjëra, planifikimin e dobët dhe menaxhimin e dobët të buxhetit, e theksoi anëtar i Kuvendit të Komunës z. Naser Graiçevci, se në baza reale, neve na mungon informacioni për shpenzimin e buxhetit komunal deri tani. Në arsim planifikohen mjete financiare për paga dhe mëditje, por kjo nuk sqarohet me letra, në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, planifikohen për shpenzim 30,000.00€, por nuk sqarohet destinimi i tyre, përshkrimi i nevojave reale për shpenzim, për komunal planifikohen 50,000.00€, në shëndetësi dhe arsim planifikohen mjete financiare për shpenzim, pa përshkrim të destinimit të tyre, te kategoria e projekteve kapitale, ndahen mjete financiare për rastet sociale, unë me vite kam kërkuar që ndarja e buxhetit të jetë së paku e barabartë për shëndetësinë dhe mirëqenien sociale, kjo më në fund ka ndodhur me shuma të përafërta në buxhetin e vitit 2020, sepse kam menduar se shëndetësia duhet të jetë me prioritet dhe në përputhje me nevojat reale të qytetarëve për ofrimin e shërbimeve shëndetësore. Në Zyrën e Kryetarit të Komunës planifikohet për subvencione shuma prej 30,000.00€, kjo është e lartë, këto mjete financiare duhet të jenë në buxhetin e shëndetësisë, sepse ata i dinë më së miri nevojat për ndihmë pacientëve. Te kultura, rini dhe sporti, shumica e mjeteve financiare shpenzohen për aktivitete kulturore, me vizita të ndryshme madje edhe në Arabinë Saudite, sporti është lënë anash, ose thënë më saktë, nuk e ka trajtimin e merituar, konform rezultateve të arritura nga klubet dhe sportistët tanë, kjo punë kështu nuk është në rregull. Ne i kemi ndarë edhe shumën prej 38,000.00€ për klubin e futbollit, por bordi u shkarkua dhe sporti dështoi krejtë, pa e dhënë asnjë llogari për buxhetin e shpenzuar nga taksapaguesit tanë. Në shëndetësi duhet të ndahen më shumë mjete financiare, sepse sëmundja nuk pret, ndërtimi i shtëpive mund të bëhet edhe më vonë, ne e dimë se ka nevoja edhe për ndërtimin e shtëpive, por jo t'i jepet prioritet para shëndetësisë. Ne i kemi

disa objekte banesore edhe në fshatin Miradi e Epërme, që mund të shfrytëzohen nga rastet sociale, unë e kam vizituar familjen Obërtinca, rastet si ajo ku objektin e tyre të banimit e kishte mbuluar myky duhet të trajtohen sa më shpejtë që është e mundur, por jo edhe rastet tjera që nuk janë në gjendje të rëndë.

Nënkryetari i Komunës: Të gjithë u ndërlidhet me planifikimin e mjeteve financiare për shpenzim në Zyrën e Kryetarit të Komunës, pa të drejtë, ju duhet ta dini se Kryetari i Komunës e merrë vendimin përfundimtarë për secilin shpenzim.

Drejtori për Financa dhe Buxhet: Një shumë e caktuar e mjeteve financiare të planifikuara rreth 20,000.00€ në Zyrën e Kryetarit të Komunës, do të shpenzohen për realizimin e marrëveshjes me Organizatën Ndërkombëtare për Migrim 'IOM-in' dhe Ambasadën e Britanisë së Madhe.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim 'Propozimin për rritjen e të hyrave vetanake për vitin 2020', me bartjen e mjeteve financiare në shumë prej 20,000.00€ për shpenzim në kategorinë ekonomike të subvencioneve nga Buxheti e Financat, në Kulturë, Rini dhe Sport.

U votua me: njëzet e një vota 'për', katër 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej njëzet e pesë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e aprovoi 'Propozimin për rritjen e të hyrave vetanake për vitin 2019', me bartjen e mjeteve financiare në shumë prej 20,000.00€ për shpenzim në kategorinë ekonomike të subvencioneve nga Buxheti e Financat, në Kulturë, Rini dhe Sport dhe mori:

V E N D I M

Për rritjen e të hyrave vetjake për vitin fiskal 2019, në shumën prej 550,000.00€, të shpërndara nëpër kategoritë ekonomike të pagave dhe meditejeve, mallrave e shërbimeve, shpenzime për komunalë, subvencioneve e transfereve dhe investime kapitale.

Koha e pushimit prej 10 minutave.

Pika e katërt (4) - Propozim për ndërtimin e objektit shkollor në Fushë-Kosovë.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për ndërtimin e objektit shkollor në Fushë-Kosovë', ku nevoja për një shkollë të re është e madhe, për arsye të migrimit të popullatës nga të gjitha Komunitatet e Kosovës dhe rritjes enorme të numrit të nxënësve, andaj propozojmë që në funksion të saj të këmbehen 57m² pronë komunale me 57m², ftoi Drejtorin e Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës që të na jap sqarime më të detajizuara.

Drejtori për Gjeodezi, Kadastrë dhe Pronë: Përsëritet të pranishmit në mbledhje. Këtu kemi të bëjmë me një kërkesë të Kompanisë Ndërtimore 'Al Trade', ku kërkohet të ndërrohet prona komunale me numër 1038 me pronën e 'Al Trade' me numër 2054 në sipërfaqe të njëjta, sepse kemi të bëjmë me një rrugë qorre që hyn në pronën e Kompanisë Ndërtimore 'Al Trade', këtë punë e kemi sqaruar dje edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa, bashkë me përfaqësuesit e deleguar nga subjekti që e kërkon ndërrimin e pronës.

Durim Hajra: Në pjesën tekstuale propozohet të bëhet ndërtimi i objektit shkollor në Fushë-Kosovë, ndërsa në dokumentacionin e palës, kërkohet të këmbehen pronat, ku nuk specifikohet

interesi publik i komunës. Në vendin ku thuhet se do të ndërtohet shkolla ekziston objekti banesor, aty është e lirë vetëm një hapësirë shumë e vogël, ne nuk e kemi të identifikuar ngastrën kadastrale për ndërtimin e shkollës, që do ta arsyetonte këmbimin e pronës komunale me pronën private të përbashkët për arsye të rrugës qorre, që edhe ashtu është në sipërfaqe të vogël prej vetëm 57m². Përveç kësaj këto prona në gjeoportat janë në kuadër të Komunës së Graçanicës. Nëse hedhen në votim të dyja kërkesat në këtë formë, ne jemi kundër. Në parim e përkrahim propozimin për ndërtimin e shkollës.

Driton Ademi: Ligji e lejon që në emër të interesit publik të këmbehen pronat, por propozimi në fjalë duhet ta ketë një riformulim, conform kërkesës së Kompanisë 'Al Trade', ne kemi material për ngastrën kadastrale të personit juridik Kompanisë në rastin tonë, por nuk kemi material për pronën komunale. Kërkesa për ndërtimin e objektit shkollor deri në identifikimin e saktë të ngastrës kadastrale duhet të shtyhet. Sipas ligjit Kryetari i Komunës duhet ta bënë shpalljen e pronave për interesin publik në ueb-faqen e komunës, këtë punë e definon qartë neni 10 i ligjit për këmbimin e pronave, të cilat pastaj, pas vlerësimit të tyre mund të këmbehen.

Remzi Shala: Ne Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, sipas nenit 25 të ligjit për shfrytëzimin dhe këmbimin e pronave komunale Nr. 06/L-092, lejohet të këmbehen pronat komunale me pronat private në territorin e komunës, për përmbushjen e interesit publik, nëse pronat e caktuara nuk janë në kontest gjyqësorë, andaj në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, ne e përkrahim për aprovim 'Propozimin në fjalë për këmbimin e pronave', meqë komuna nuk ka pronë publike për ndërtimin e shkollës, e cila është shumë e nevojshme për qytetin tonë.

Driton Ademi: Kush i siguron mjetet financiare për ndërtimin e shkollës, të nderuarë kolegë propozimi nuk përputhet me kërkesën.

Nënkryetari i Komunës: Unë e kam dëgjuar përfaqësuesin e Kompanisë 'Al Trade', se ata do të ndajnë një hapësirë deri në shtatëmbëdhjetë ari tokë për ndërtimin e shkollës, kjo hapësirë duhet të kompensohet me bonuse të ndërtimit sipas Hartës Zonale të Komunës. Ne ndërrimin e pronës mund të kushtëzojmë me një klauzolë, që parasheh identifikimin e ngastrës kadastrale për ndërtimin e shkollës.

Durim Hajra: Është sqaruar edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa, dokumenti nuk ka asnjë lidhje me fletën e parë, ne nuk mund të votojmë dokument të falsifikuar. Këto prona janë në Zonën Kadastrale të Uglarit, që nuk është pjesë e komunës tonë.

Drejtori për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë: Para vetës e kam dokumentin numër 29, ora 09.20 minuta, që është i nxjerrur në Zyrën tonë kadastrale, unë nuk mund të nxjerrë fleta poseduese të komunës fqinje.

Mehdi Lahu: Ne duhet ta dimë se çka po votojmë, këmbimin e një prone komunale që hyn si rrugë qorre në pronën private, këmbimi bëhet për interesin e shkollës me kompensim përmes bonuseve të ndërtimit.

Aida Alimi: Unë dua t'iu njoftoi se këtu kemi të bëjmë me pronën e katër pronarëve, që e kanë dhënë për ndërtim të lartë, jo me pronën e Kompanisë 'Al Trade', në mesin e pronarëve është edhe bashkëshorti im, andaj unë nuk do të jem pjesëmarrëse në votim lidhur me këtë çështje.

Shaban Ademi: Ne edhe si pozitë edhe si opozitë duhet të jemi fleksibil, kur janë në pyetje interesat e përgjithshme, nevoja për ndërtimin e një shkollë në anën e djathtë të rrugës Fushë-Kosovë/Prishtinë është shumë e madhe, andaj duhet ta gjejmë një model të kompromisit, sepse kemi megrim të madhë të popullsisë për shkak të ndërtimeve të larta dhe rritje enorme të numrit të nxënësve, me tendencë të rritjes edhe në vitet e ardhshme. Ofertuesi Kompania 'Al Trade', i ka interesat e veta, por edhe ne duhet ta shikojmë interesin tonë për ndërtimin e shkollës, këtu interesi është i dyanshëm. Harta Zonale e Komunës do të vlenë për tetë vitet e ardhshme, kjo është një mundësi e jona që ta ndërtojmë një shkollë të re me një kapacitet për 2000 nxënës. Ne duhet ta obligojmë Ekzekutivin e Komunës, që ta detajizon një marrëveshje për caktimin e bonuseve të ndërtimit, në bazë të rregullave të ndërtimit dhe mbështetjes në ligj, në mënyrë që ndërtimi i shkollës të mos dështon.

Drejtori për Arsim: Të them të drejtën për mua ndërrimi i metrave të ngastrave kadastrale nuk është shumë me rëndësi, ne këtë vit shkollor i kemi patur 500 nxënës të ri, vitin e ardhshëm do t'i kemi 700 - 800 nxënës, do të na duhet që ta kthejmë ndërrimin e tretë në mësim, që do të ishte katastrofal për procesin mësimorë. Ne tani i kemi 45-47 nxënës në një klasë, për neve interesi i shkollës është në rendin e parë, normal se aty ku ka shkollë edhe banesat shiten më lehtë. Për ndërtimin e shkollës neve, na duhen 17-33 ari tokë, për një shkollë me kapacitet prej 2000 nxënës.

Durim Hajra: Ne nuk jemi kundër ndërtimit të shkollës, por pronari sot nuk ofron asnjë ngastër kadastrale për ndërtimin e shkollës, andaj propozojmë që kjo pikë e rendit të ditës, të shtyhet për shqyrtim deri sa të na vjen 'Plani për ndërtimin e shkollës'. Këmbimi i pronës dhe shkolla janë të ndara.

Nënkryetari i Komunës: Zona për ndërtimin e shkollës është e caktuar, tani nuk mund t'i caktojmë vetëm bonuset e banimit, andaj duhet ta marrim një vendim për këmbimin e 57m², me 57m² të pronave.

Drejtori për Arsim: Nuk ka pengesa, zona për ndërtimin e shkollës është e caktuar, kjo punë është serioze, do ta kemi edhe projektin e detajizuar për ndërtimin e shkollës.

Nënkryetari i Komunës: Nëse nuk ofrohet prona për ndërtimin e shkollës, ne e anulojmë vendimin e marrë për këmbimin e pronave.

Ali Ismaili: Ne tani këtu po e kuptojmë se duhet ta marrim një vendim, duke u mbështetur në parimin e mirëbesimit, ne nuk jemi kundër ndërtimit të shkollës, unë çdo herë në Kuvendin e Komunës kam kërkuar që të përkrahen arsimi dhe shëndetësia. Unë pajtohem me mendimin e anëtarit të Kuvendit të Komunës z. Shaban Ademi se shkolla është e nevojshme të ndërtohet, të fillohen procedurat, sepse procesi i ndërtimeve sipas Projekt-Hartës Zonale të Komunës do të bëhet në tetë vitet e ardhshme. Por duhet të kemi kujdes, sepse na mungon plani për ndërtimin e shkollës dhe nuk e kemi të qartë dhe definuar tani sa do të lejohet ndërtim përmes bonuseve për pronarin privat, qyteti ynë është shndërruar në një katrahur, sa i përket ndërtimit. Unë pajtohem që ky vendim të merret në mirëbesim me kusht që shkolla të ndërtohet në atë pjesë të qytetit tonë.

Naser Graiçevci: Ne e dimë që titulli i propozimit nuk përputhet me kërkesën për këmbimin e pronave, por unë dua të ndërlidhem me mendimin e Nënkryetarit të Komunës, që këtë vendim ta

marrim me një kushtëzim, ne t'i përmbahemi këtij vendimi, nëse nuk ofrohet prona për ndërtimin e shkollës, ta anulojmë si Kuvend i Komunës vendimin.

Driton Ademi: Nevoja për shkollë ekziston, pse nuk kem shkollë dhe e kemi këtë katrahur në ndërtim, përgjegjës është pushteti aktual, ne këtu jemi që të punojmë dhe veprojmë formalisht, këmbimi i pronave duhet të bëhet përmes shpalljes publike. Nisma Socialdemokrate jemi kundër marrjes së vendimit në këtë mënyrë.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin për këmbimin e pronës komunale me pronën e Kompanisë 'Al Trade', në sipërfaqe të barabarta prej 57m², me kushtëzimin e zbatimit të vendimit me caktimin e ngastrave kadastrale për ndërtimin e shkollës.

U votua me: njëzet e një vota 'për', një 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e dy anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e aprovoi 'Propozimin për këmbimin e pronës komunale me pronën e Kompanisë 'Al Trade' në sipërfaqe të barabarta prej 57m², me 57m², me kushtin e caktimit të ngastrave kadastrale për ndërtimin e objektit shkollor në këtë zonë të qytetit dhe mori:

V E N D I M

1. Për lejin e këmbimit të pronës komunale në sipërfaqe S=57m² nga sipërfaqja e përgjithshme prej S=1450m² e Ngastrës Kadastrale me Nr. P-72514036-01038-0 P.Sh Infrastrukturë - rrugë, me pronën private në sipërfaqe prej S=57m² nga sipërfaqja e përgjithshme prej S=2132m² e Ngastrës kadastrale me Nr. P-72514036-02654-0 e kategorisë bujqësore/arë e klasës të katërt, në pronësi të pronarëve: Izeir Fejzullahu, Kadri Alimi, Samedin Mjeku dhe Milaim Kryeziu, e lejuar për Kompaninë 'Al Trade Center' me numër identifikues të biznesit 811167924, pronar Sokol Nasuf Gashani, sipas matjeve gjeodezike të propozuar nga raporti për vlerësimin e pronave i realizuar me datën 01.06.2019, nga vlerësuesi për prona të paluajtshme i shkallës së parë.
2. Këmbimi i sipërfaqeve të ngastrave kadastrale sipas pikës një të vendimit, lejohet vetëm pas identifikimit të pronës së paluajtshme për ndërtimin e objektit shkollor në Fushë-Kosovë.

Pika e pestë (5) - Propozim për themelimin e Komitetit për Politikë e Financa.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim, pikën shtesë, 'Propozimin për plotësimin e Komitetit për Politikë e Financa, por përfaqësuesi i Partisë Demokratike të Ashkalinjëve të Kosovës mungon, andaj nuk mund ta shqyrtojmë.

Ali Ismaili: Procesit të themelimit të Komitetit për Politikë e Financa i ka dalur ngjyra në komunën tonë, meqë nuk është vepruar sipas ligjit dhe rezultatit zgjedhor në fillim, por as më vonë ashtu si parashihet edhe me Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2018 për përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të Përhershme në Komuna. Për dy vite ju e shtyeni këtë punë pa nevojë dhe veproni në kundërshtim me ligjin, pjesëmarrja në Komitetin për Politikë e Financa e subjekteve politike shkon sipas radhitjes së tyre në zgjedhje, ku ka patur mundësi reale që të gjitha subjektet politike t'i kenë përfaqësuesit e tyre në dy Komitete të Përhershme në Komunën tonë.

Driton Ademi: Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2018, e ka ndryshuar Udhëzimin Administrativ të vitit 2014 dhe e ka definuar pjesëmarrjen e subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvendin e

Komunës, në Komitetin për Politikë e Financa sipas renditjes së tyre në zgjedhje, e jo sipas përqindjes, ku eliminohet përfaqësimi në trupat e Kuvendit të Komunës për subjektet politike nga ana e juaj. Ky Udhëzim Administrativ është dashur të zbatohet deri me datën 31 mars 2019. Anëtarët e Komiteteve të Përhershme nuk kanë të drejtë të jenë anëtarë të Komiteteve tjera konsultative, andaj në këtë mënyrë do ta kemi një gjithëpërfshirje dhe zbatim të ligjit dhe udhëzimit administrative.

Nënkryetari i Komunës: Ne po mbesim në qëndrim të njëjta, Komiteti për Politikë e Financa duhet të plotësohet me anëtarin e shtatë z. Hysni Hasani nga Partia Demokratike e Ashkalinjëve të Kosovës.

Durim Hajra: Këtu gjendja është e qartë, duhet të zbatohet Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2018 për themelimin dhe përbërjen e Komiteteve të Përhershme në Komunë.

Remzi Shala: Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, propozojmë, që këtë gështje ta shtyejmë për mbledhjen e ardhshme dhe ta përfundojmë duke e plotësuar përbërjen e Komitetit për Politikë e Financa.

Bashkim Krasniqi: Përsëritës në mbledhje. Sipas rezultatit zgjedhor mua më takon që të jem anëtar i Komitetit për Politikë e Financa.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: Atëherë ne tani do t'i ndërronim dy anëtarë të Komitetit për Politikë e Financa, do të largohet përfaqësuesi i deritani në tani dhe z. Driton Adem. Shtohen anëtarët e Kuvendit të Komunës z. Hysni Hasani dhe z. Driton Adem.

Driton Adem: Përfaqësimi shkon sipas radhës deri në subjektin e shtatë, këtë e ka përcaktuar rezultati zgjedhor.

Nënkryetari i Komunës: Ne nuk lëshojmë pe tani, përbërja e Komitetit për Politikë e Financa mbetet sipas përqindjes së subjekteve politike, megjë ju nuk po pajtohemi me zgjidhjen e këtij problem ashtu si u propozua dhe në shumicën e Komunave të Kosovës këto komitete janë të themeluara në bazë të përqindjes.

Driton Adem: Unë do të qëndroj në sallën e Kuvendit të Komunës pas mbledhjes, megjë nuk po lejohet të realizohen të drejtat tona që na takojnë sipas ligjit në fuqi.

Ali Ismaili: Kjo punë është ka kuptim, sipas radhës në zgjedhje, anëtar i Komitetit për Politikë e Financa, jam edhe unë si përfaqësues i Partisë së Drejtësisë, sepse është e ka përcaktuar votues dhe ligji.

Naser Graiçevci: Pozicionet tani janë të qarta, këtu po mbizotëron politika e dominimit, ligji duhet të zbatohet, Lidhja Demokratike e Kosovës po thirret në atë se ky udhëzim administrativ nuk është zbatuar as në komunat tjera, por kjo nuk duhet të nënkupton se ne duhet ta shkelim ligjin. Ne tani i kemi dy propozim njërin sipas radhës dhe tjetrin sipas përqindjes së subjekteve politike.

Bashkim Krasniqi: Si subjekt politikë unë në radhë me vota jam para Nismës Socialdemokrate.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: Pas diskutimeve propozoi që të votohet 'Propozimi për plotësimin e Komitetit për Politikë e Financa me përfaqësuesin e Partisë Demokratike të Ashkalinjëve të Kosovës dhe Nismës Socialdemokrate.

Ali Ismaili: Sipas vendimit të Ministrisë duhet të përfaqësohen shtatë subjekte politike.

Nënkryetari i Komunës: Unë me 46% të votave në zgjedhje nuk ua lëshoj shumicën e përfaqësimit në Komitetin për Politikë e Financa.

Remzi Shala: Tani meqë po kemi paqartësi, fuqi politike është në anën tonë, unë propozoi që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e ardhshme.

Durim Hajra: Ne kërkojmë që të hedhet në votim propozimi i parë sipas rezultatit zgjedhor deri te partia e shtatë në Kuvendin e Komunës.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin e paraqitur nga Shefi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për shqyrtim në mbledhjen e ardhshme'.

U votua me: trembëdhjetë vota 'për' nga gjithësej njëzet e pesë anëtarë të pranishëm në mbledhje, andaj Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se kjo pikë shtyhet për mbledhjen e ardhshme. Përfaqësuesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës pas këtij votimi e lëshuan sallën, anëtarët e tjerë të Kuvendit të Komunës nga subjektet politike të opozitës në Kuvendin e Komunës qëndruën në sallën e Kuvendit të Komunës për të shprehur pakënaqësinë e tyre lidhur me këtë çështje, mirëpo meqë në sallë ishin të pranishëm vetëm trembëdhjetë anëtarë të Kuvendit të Komunës, me Kryesuesen e Kuvendit të Komunës, në vazhdim Kryesuesja e shpalli të mbyllur mbledhjen e sotme.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje. Mbledhja përfundoi në orën 13:45h.

Procesmbajtës
Hasan Gjyrevci



Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha

